




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Procesverbal i Dëgjimit Buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029

Data: 03.06.2026

Ora: 13:30

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, kati IV

Të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku, nënkryetari z. Fadil Nura, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, drejtorët tjerë komunal.

Behxhet Maliqi: Mirëdita të gjithëve, faleminderit që i jeni përgjigjur ftesës së kryetarit për me shqyrtu Kornizën Afatmesme Buxhetor për vitin 2027, 2028 dhe 2029. Ky është prej atyre dokumenteve mjaft të rëndësishëm në kuadër të buxhetit komunal, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij dokumenti strategjik tre vjeçar, kryetari në bazë të kompetencave të cilat i jep ligji e ka bërë këtë ftesë publike e cila përfshinë shoqërinë civile, organizatat jo qeveritare dhe personat të cilët janë të interesuar në mbarëvajtjen e procesit komunal dhe orientimin e politikave zhvillimore për këtë tre vjeçar. Fjalën ja kaloj kryetarit.

Kryetari Sami Lushtaku: Faleminderit drejtor, përshëndetje për të gjithë. Me vjen mirë që jam në këtë dëgjim buxhetor, dëshira dhe vullneti është që buxheti të jetë një buxhet pak ma ndryshe, por e vërteta dhe realiteti janë diçka tjetër, është ky buxhet që është. Qeveria në nivel qendror duhet të jetë me gjithëpërfshirëse, ta përfshijë me shumë edhe komunën e Skenderajt. Shpresoj që vitin tjetër kemi me pasë më shumë mundësi për nevojat e qytetarëve tonë, sepse komuna ka ende shumë nevoja, kemi rrugë të papërfunduara e sidomos kanalizime, kemi nevojë më të madhe se për diçka tjetër. Ujin po e dini secili, ka qenë një projekt që vërtetë e kish bërë zgjidhjen e komunës sonë, jo vetëm të komunës por edhe fshatrave përreth, por që qeveria nga viti 2020 nuk ka bërë diçka në këtë drejtim.. Prandaj po besoj që këtë mandat kemi me zgjedh një pjesë të problemeve që i ka komuna jonë. Drejtori është me kompetent për gjithçka që kërkohet nga qytetarët, ky do të mbaj shënime. Edhe një herë faleminderit.

Nënkryetari Fadil Nura: Faleminderit kryetar, të nderuar bashkëqytetar, drejtor të drejtorive, është kënaqësi e veçantë të jemi sot bashkarisht këtu me ju informu sepse është procesi i buxhetimit të komunës, përkatësisht i Kornizës për tre vjet e ardhshme, kufijtë të cilët do të vazhdojmë në hartimin e buxhetit, shkon me faza sipas legjislacionit në fuqi, është ky inicimi i parë që përcaktohet me ligj, dëgjim buxhetor fiskal, që nënkupton njohuritë e juaja fillestare. Sigurisht edhe dëgjimet e ardhshme që do të mbahen nëpër Bashkësi Lokale, është e rëndësishme më qenë proaktiv rreth kërkesave dhe nevojave që janë, një pjesë të madhe i dimë, disa projekte i kemi buxhetuar, e disa në procedurë që na kanë mbetur në gjysmë do të vazhdojnë këtë vit. Është e rëndësishme që nevojat me i degju direkt nga ju në mënyrë që ato pastaj të shqyrtohen për në procedurat tjera, deri në aktin final të miratimit këtu në Kuvend të Komunës nga Asambleja në mënyrë që të implementohen për vitin e ardhshëm dhe projeksionet për dy vitet e ardhshme në kuadër të KAB-it. Faleminderit drejtor, e ke fjalën.

Behxhet Maliqi: Faleminderit nënkryetar, kjo është faza e parë e hartimit të buxhetit komunal, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2027-2029. Vlen të ceket që buxheti komunal për këtë tre vjeçar, i cili për vitin 2027 është buxhet aplikativ, ndërsa për vitin 2028-2029 janë parashikime, i ka disa karakteristika, përbëhet nga një strukturë që është grand i përgjithshëm ku qeveria ndan mjete në bazë të ligjit që është i obligueshëm, tatimet që i mbledh nga qytetarët me i kthy në komunat dhe organizatat buxhetore. Ky grand qeveritar është 9.419.732€, gjithashtu e ka edhe një grand të veçantë që është grand për arsimin, që ndahet në bazë të numrit të nxënësve që e ka çdo komunë, në këtë rast i kemi 7.060.106€ që është 609.980€ më i vogël sesa vitin e kaluar. Gjithashtu është edhe granti tjetër, granti për shëndetësi i cili është 2.344.143€ ky grand është rrit për 160.000€ ndërsa pjesa tjetër për shërbimet rezidenciale, jemi dëshmitar që ne kemi një shtëpi për përkujdesje ndaj të moshuarve dhe granti për këtë është 200.000€, vlen të ceket që 50% e shpenzimeve për këtë institucion duhet ti mbulojë komuna prej të hyrave të saj. Për shkak se qeveria vazhdon me vite të tëra mos me i mbulu shpenzimet për këtë institucion. Të hyrat komunale të planifikuara me u realizu këtë vit janë 9.790.818€, total buxheti të cilin e kemi në dispozicion është 20.814.709€, vlen të ceket që mbi 12 milion janë paga të cilat realisht nuk mund të hynë në asnjë proces, qoftë mallra shërbime, qoftë investime kapitale ose subvencione. Meqenëse kemi këtu prej shoqërisë civile, OJQ-ve dhe qytetarë të cilët janë të interesuar për mbarëvajtjen e procesit për planifikimin buxhetor në komunë. Dua t'u jap mundësinë, me i degju nevojat dhe kërkesat që i keni, gjithashtu edhe sugjerimet të cilat ne duhet t'i kemi parasysh në rastin e përfundimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Po e hap debatin.

Sadri Gaxhiqi: Fjala përshëndetëse. Rreth projekteve në fshatin Murgë, kanë mbetur 900m rrugë të pa përfunduara, gjithashtu edhe kanalizimi i pa përfunduar në lagjet Gaxhiqi dhe Islamaj. Po ashtu edhe ndriçimi publik si dhe mungesa e ujit të pijes përkundër që rrjeti është i shtrirë. Desha të di a përfshihen në projekt këto kërkesa?

Behxhet Maliqi: Ne si komunë e kemi në projekt rrjetin e kanalizimit në të gjitha BL dhe fshatra, por sfidë mbetet buxheti për shkak që përmbaruesi i ka marrë mjetet financiare dhe këto projekte nuk kanë mundur të realizohen. Do të bëjmë përpjekje maksimale me e realizu çdo kërkesë të qytetarëve. Gjithashtu edhe pjesa e rrugëve është projekt që vazhdimisht na janë marrë mjetet financiare nga përmbaruesi duke zbatuar kontratën kolektive. Është e pamundur me këtë buxhet me arrit me i realizu komplet kërkesat për rrugë dhe kanalizim.

Dikush tjetër.

Xhevrije Thaqi: Fjala përshëndetëse. Jetoj në lagjen II, rr.28 shkurti, tash e 15 vite kemi probleme me furnizim me ujë, gjatë ditës mungesë kurse gjatë natës në ora 00:00 vie uji, dimrit paraqet rrezik për gypat e ujit në shtëpi nga ngrirja e gypave dhe cisternës, po ashtu edhe shtypja e ulët e ujit. Kur do të zgjidhet ky problem?

Fadil Nura: Faleminderit për pyetjet, z. Gaxhiqi është e rëndësishme me ju njoftu që pjesa më e madhe e rrugicave janë të kontraktuara, problem kemi me pas ekzekutimin, sepse jemi godit nga kontrata kolektive në arsim dhe jemi të penalizuar nga përmbaruesit. Në disa fshatra na u kanë ndal punët në gjysmë, sepse janë marrë mjetet. Ndriçimi është i kontraktuar është duke vazhduar, nuk kemi mundur me implementu sipas planit që e kemi pas pikërisht për shkak të problemeve buxhetore.

Sa i përket problemit të ujit e kemi diskutuar me menaxhmentin e ujësjellësit e cila kompani ka kompetencë të furnizimit me ujë dhe nuk është kompani lokale por qeveritare, kompetencë e tyre është mirëmbajtja e rrjetit dhe investimet ku ka nevojë. Është mirë të bëni një peticion me të gjitha familjet dhe ta dorëzoni një kopje në ujësjellës dhe një në komunë, ne jemi të gatshëm të bëjmë presion institucional dhe bashkë me ujësjellësin ta zgjidhim këtë problem.

Faleminderit. Dikush tjetër?

Arsim Haziraj: Fjala përshëndetëse. Desha të pyes nënkryetarin a ka mundësi që neve si HANDIKOS të na përfshini në linjën buxhetore të komunës, kjo shoqatë i ka mbi 650 anëtar, me një objekt më të mirin në Kosovë por po na mungon buxheti dhe jemi duke funksionuar në baza vullnetare.

Shyqeri Gaxhiqi: Fjala përshëndetëse. Jam fermer, posedoj 200 krerë dhi, 10 lopë si dhe 20 hektarë tokë të punueshme. Desha të pyes drejtorin, ne aplikojmë për subvencione dhe asnjëherë nuk përfitojmë. Dua të di cila është arsyeja?

Fadil Nura: Arsim e di që keni nevojë dhe mirë është me ju përfshi në buxhet por çështjen e përkrahjes suaj mund ta bëjmë përmes subvencioneve, kur të keni kërkesa, ne shpesh kemi thirrje për përkrahje të OJQ-ve sepse ju statusin e keni të OJQ-së. Vetëm kështu mundemi me ju përkrah. Sa i përket z. Gaxhiqi jemi munduar t'i ndihmojmë fermerët dhe bujqit, obligim i yni është t'i ndihmojmë ata që punojnë.

Behxhet Maliqi: Pavarësisht vullnetit me i ndihmu fermerët, kërkesat janë më të mëdha sesa mundësitë që i kemi pas. Drejtori i Bujqësisë do ta ketë në konsideratë rastin tuaj dhe rastet tjera të ngjashme, në projektet e reja.

Dikush tjetër.

Hana Zabeli: E kam një kërkesë me ndërru kryetarin e fshatit sepse ka 2 vite që banon në Prishtinë dhe kemi mbet anash si fshat, fshati Rezallë e Re.

Behxhet Maliqi: Në Asamble ka kaluar komisioni për përzgjedhjen e kryetarëve të fshatrave, është e vërtet që ka vite që nuk janë mbajtur zgjedhjet, shpejt ka me fillu punën komisioni dhe kemi me i zgjedh kryetarët e ri.

Nëse nuk është dikush tjetër, ju falënderoj për pjesëmarrjen, i kemi marrë shënimet dhe çdo kërkesë tuajen kemi me u mundu maksimalisht me e fut në buxhet me qëllimin që buxheti me qenë sa më i përgjegjshëm dhe afër qytetarëve.

Faleminderit shumë. Me kaq e mbylli këtë takim, shihemi në takimet e radhës.






Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin buxhetor publik me qytetarë për KAB 2027-2029

Dëgjimi buxhetor me përfaqësuesit e lagjeve dhe fshatrave, OJQ-të, shoqatat e grave, shoqërinë civile, bizneset, fermerët, të rinjtë e studentët e Komunës së Skenderajt dhe të gjithë të interesuarit e tjerë.

E mërkurë, 03 Qershor 2026, 13:30

Salla e Kuvendit komunal, KATI IV

Emri dhe Mbiemri	Lagjja/Përfaqësimi	Nënshkrimi
Ali Aliu	shenderaj L.1	
ALBAN VOSKODA	LAGJA 3	
Bledion Meha	Lagjia 3	
Zabimot Anushtemaj	Lagjia Punskimi Gubrot	
Linidom Fazliu	Lagjia shtauhera Rumik	
Leotrim Brahimi	Baks	
DIEDON RUSHITI	SKENDERAJ L.1	
Leonard Mehmetaj	Kosterc	
Valdrin Kadriu	Litoc	
Altin Veseli	Skenderaj	
FATON OSMANI	BAKS	
LEONARD KARRIHANI	BAKS	
ALBAN MUSA	PRERAZI ORERAN	
Miranda Beçi	Lagjia II	
Fazile Hajraj	Rakinicë	
Higena Geci	Lagjia II	
DOMART THAQI	BURROJE	
Hubib Hoxhaj	Memi Recsen	
Xhavit Seferi	kozhicë	
Albulena Hoxha	Albulena B.1	
Agnesa Hoxhaj	Skenderajca	
Natyna Thaqi	KPP-SHPRESA	

